REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJE

Nr._____prot Lushnje më, __/__/2024

SHPALLJE PËR SHËRBIMIN VULLNETAR NË SEKTORIN E MZSH-së

BASHKIA LUSHNJE

Në zbatim të Ligjit Nr. 152, datë 21.12.2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij; Ligji 45/2016 "Për Vullnetarizmin" dhe VKB Nr.103, datë 30.11.2022 "Për ngritje e shërbimit vullnetar për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi" pranë Bashkia Lushnje.

Në kuadër të përmbushjes së objektivave ligjore vullnetarizmi konsiderohet si një nga konponentët me vital të sistemit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi. Promovimi i vullnetarizmit në strukturat e shërbimit të MZSH-së është jashtëzakonisht i rëndësishëm në forcimin e kapaciteteve për grupet zjarrëfikëse që operojnë në territorin e Bashkisë Lushnje.

Ekipet vullnetare varen nga drejtuesi i shërbimit zjarrëfikës dhe mund të operojnë çdo ditë të vitit, në shpëtimin e jetes,gjësë së gjallë,pronës,mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidente të ndryshme fatkeqësi natyrore si dhe ato të shkaktuara nga dora e njeriut.

Shërbimi vullnetarë për mbrojtje nga zjarri dhe shpëtimi është pjesë e sektorit të MZSH-së Lushnje dhe ka një strukturë prej 20 vullnetarësh.

Vullnetaret mund të jenë të gjithë qytetarët të cilët përmbushin kushtet dhe kriteret sipas Ligjit nr. 45/2016 "Për Vullnetarizmin".

Kohëzgjatja ditore e vullnetarizmit është jo më shumë se 5 orë në ditë dhe jo më shumë se 25 orë në javë.

Uniforma e vullnetarit është ngjyrë jeshile pa grada dhe ka një simbol dalluse në krahun e majtë (miratuar me VKB-në nr.103,datë 30.11.2022).

Ofruesi i vullnetarizmit mund të jetë person fizik/juridik vendas ose i huaj një organizatë jo fitimprurese, organ publik ose bashkësi fetare.

KUSHTET DHE KRITERET

-Të jetë në gjëndje të mirë shëndetsore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyrat;

-Të mos jetë i/e dënuar me vendim të forcës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

-Fotokopje e kartës së identitetit;

-Çertifikatë familjare;

-Dokument i lëshuar nga institucionet shëndetësore që vërteton se nuk është përdorues i lëndëve narkotike;

-Dëshmi penaliteti;

Dokumentat të dorëzohen pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore brënda datës 17.05.2024.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore